



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 71, datë 20.02.2020

**PËR
DETAJIMIN E BUXHETIT NË SHPENZIME KAPITALE PËR SISTEMIN
GJYQËSOR, PËR VITIN 2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, pika 2, shkronja “dh”, 95 e 96 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, të Ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e detajimit të fondeve buxhetore për shpenzime kapitale (investime) për vitin ushtritor 2020, si më poshtë:
 - Në programin 01110, “Planifikim, Menaxhim, Administrim” buxheti i KLGJ-së, në shumën prej 49 600 000 (dyzet e nëntë milion e gjashtëqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur;
 - Në programin 03310, “Buxheti gjyqësor” buxheti i Gjykatave, në shumën prej 158 400 000 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e katërqind mijë) lekë, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR